



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS/OPŠTINA PODUJEVO/MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREKTORIA E ARB. NENKES - URAVA ADMINISTRATIVE		
Dënuar më Dostavljeno 16.02.2024		
Nr. org. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
09-355/02-00118 31/24		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Raporti vjetor i punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2023.

Investime kapitale:

Është restauruar shkolla e vjetër e fshatit Sfeçël, në kuadër të investimeve në trashëgimi kulturore

Ka nisur ndërtimi i Qendrës Multifunktionale. Pritet të përfundoj në vjeshtën e vitit 2024.

Është ndërtuar dhe vendosur në shesh shtatorja e Adem Demaçit.

Është nënshkruar kontrata dy vjeçare për ndërtimin e fushave sportive në vlerë 425,000 euro.

Është hapur Biblioteka e Qytetit në hapësirat e objektit të vjetër të Komunës.

Subvencione:

Bazuar në thirrjet publike për financim të OJQ-ve në Kulturë, Rini dhe Sport, në thirrjet për Projektet Individuale kulturore, përmes vendimeve të kryetarit dhe përmes vendimit të Kuvendit Komunal, DKRS ka subvencionuar përafërsisht 150,000 euro. Që përben 7 fishim të subvencionimit.

Kultura:

Galeria e Arteve – 12 ekspozita për 12 muaj

Manifestime – 15 manifestime të ndryshme kulturore

Ditët e Diasporës – si asnjëhere tjetër, për 3 javë, çdo ditë ka pasur aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive në sheshin e qytetit, si koncerte, panaire, turne, etj...

Teatri – 3 premiera për skenën e mbrëmjes, 2 premiera për fëmijë, 30 repriza të shfaqjeve dhe 9 shfaqje mysafire. Kurse Teatri Avdush Hasani ka përfaqësuar Podujevën duke dhënë 7 shfaqje si mysafirë.

Kinemaja – përmes memorandumit me Qendren Kinematografike të Kosovës, është bërë transmetimi i 8 filmave prdhim vendor, në ambiente të hapura.

Botime librash – 20 libra të rinj, janë botuar vetëm në vitin 2023 me përkrahjen financiare të DKRS.

Biblioteka – Libra të rinj – 760 tituj të rinj i janë shtuar bibliotekës së qytetit, në gjithsej 4921 kopje. Kurse në Bibliotekë gjatë vitit janë regjistruar gjithsej 445 lexues, kurse janë huazuar 4012 libra. Salla e leximit është shfrytëzuar nga 4425 lexues, kurse salla e fëmijëve nga gjithsej 700 nxënës.

Panaire – Është organizuar Panairi i librit dhe 2 panaire me produkte artizanale.

Grupe të marginalizuara – Janë përkrahur projekte dhe organizuar aktivitete në mbështetje të komunitetit ashkali, në 2ulture dhe sport.

Personat me aftësi të kufizuara – janë subvencionuar ndaras, projekte sportive dhe edukative për personat e verbër.

Rinia:

Aktivitete Rinore - Përpos subvencionimit të OJQ-ve me subvencione në projektet për të rinjt, gjithashtu janë organizuar gjithsej 9 aktivitete që kanë synuar gjithëpërfshirjen e të rinjve, të cilat kanë pasur kryesisht karakter edukues në fusha të ndryshme.

Sport:

Organizime sportive – gjithsej 31 organizime sportive, si turne në Futboll, gara na Basketboll, Volejball, Bjeshkatari, Kamping, Not, Çiklizëm, Arte të Miksuara Marciale, Karate, Tenis, Ping Pong, Shah dhe të tjera me theks përfshirjen e vajzave në sport dhe përgjithësisht të të rinjve.

